



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. Prot 154

Tiranë, më 13 Maj 2020

Drejtuar: **Z. Ulsi Manja**
Kryetar
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Lënda: ***Oponencë ligjore lidhur me ndryshimet e propozuara në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD)***

I nderuar Zoti Manja,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është njohur me projektligjin e dërguar për konsultim publik "Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10221, date 04.02.2020 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si dhe me relacionin e tij shoqërues.

Që në krye të herës, KSHH vlerëson në tërësi nismën e ndërmarrë dhe vëren se për ndryshimet në këtë projektligj janë zhvilluar një sërë tryezash konsultative si nga Këshilli i Evropës por gjithashtu edhe nga vetë institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), i cili ka vendosur në lëvizje mekanizmat që mundësojnë ushtrimin e nismës ligjore për ndryshimin e këtij ligji. Një pjesë e sugjerimeve dhe komenteve të KSHH-së lidhur me nevojën e ndryshimit të këtij ligji, vërejmë me kënaqësi se janë marrë në konsideratë nga aktorët përkatës.

Megjithatë, duke patur parasysh problematikat që kanë shoqëruar në dekadën e parë zbatimin e këtij ligji, nevojat me të cilat përballen viktimat e diskriminimit dhe grupet e riskuara prej tij, si dhe nevojën për të forcuar pro-aktivizimin dhe pavarësinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dëshirojmë t'ju përcjellim në vijim disa nga mendimet dhe sugjerimet tona lidhur me këtë nismë:

a. Me shtimin e nenit 3/1, projektligji synon të zgjerojë format e diskriminimit, duke mos lënë krijimin e tyre në diskrecionin e KMD-së. KShH vëren se diskriminimi është një fenomen kompleks, i cili me zhvillimin e shoqërisë dhe të njerëzimit, dimensionit ekonomik, social, etj, mund të shfaqë forma të reja, të cilat, ashtu sikurse shkaqet e diskriminimit nuk duhet të ngurtësohen në terma absolutë në dispozitat ligjore të diskriminimit. KShH mirëpret format e reja të diskriminimit që janë shtuar në nenin 3/1, që reflektojnë edhe gjetjet e evidentuara në Progres Raportin e Bashkimit Europian për Shqipërinë për vitin 2019¹, por nga ana tjetër, vlerëson se KMD-së dhe gjykatës, duhet t'i lihet në çdo rast diskrecioni për të vlerësuar forma të tjera diskriminimi, në varësi të specifikave dhe veçorive të secilit rast, duke u bazuar në konceptin e përgjithshëm dhe

¹ "Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi" nuk adreson konceptin e diskriminimit të shumëfishtë.
<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

